



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**  
**FAKULTETI I BUJQESISË DHE MJEDISIT**  
**DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISË**

**Lënda:** Info rreth Kursit të “Vlerësimi i pasurive të paluajtshme për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë dhe tokë e pafrutëshme”

Një vlerësim i pronës që konsiderohet të jetë e përshtashme për zhvillim, ose ri-zhvillim, mund të kërkohet për shumë arsye. Këto mund të përfshijnë këshilla për sigurinë e kredisë, blerjen, shitjen, vlerësimin e opsioneve, tatimet kapitale, qëllime të planifikimit dhe vlerësimeve, etj.

Qëllimi i këtij programi të vlerësimit të tokës bujqësore, pyjeve, kullotave dhe tokës së pafrutëshme është që të ofrojë një kornizë efektive, Brenda rregullave të sjelljes, në mënyrë që pronarët e tokës mund të kenë besim se një vlerësim i siguar nga një vlerësues profesionist është objektiv dhe është në përputhje me standartet kombëtare duke përfshirë ato të përcaktuara nga Këshilli Ndërkombëtar i Standarteve të Vlerësimit (IVSC). Këto standarte përcaktojnë rregullat, procedurat dhe udhëzimet përvlerësuesit në kryerjen e procesit të vlerësimit. Ata vënë një kornizë për praktikat më mira në ekzekutimin dhe dorëzimin e raporteve të vlerësimeve për qëllime të ndryshme dhe i siguron vlerësuesit se si të vlerësojnë në rastet individuale.

Nëpërmjet këtij kursi do të përcaktohet dhe sigurohen elementët e mëposhtëm:

- 1.Kualifikimin e duhur të vlerësuesëve për detyrën, gjykuar ndaj kriterëve të qarta;
- 2.Pavarësinë dhe objektivin në qasjen e vlerësuesit;
- 3.Qartësi në lidhje me kushtet e angazhimit, duke përfshirë çështjet që duhet të adresohen dhe shpalosjet që duhen bërë;
- 4.Qartësi në lidhje me bazën e vlerës, duke përfshirë çdo supozim apo konsideratë materiale që do të meren në konsideratë;

5. Standartet minimale në lidhje me përmbajtjen e raporteve të vlerësimit;
6. Zbulimi i duhur dhe i përshatshëm i çështjeve relevante ku vlerësimet mund të jenë të mbështetur nga një palë e tretë.

Organizimi i kursit të pasurive të paluajtshme për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadhe dhe tokë e pafrutëshme do të zhvillohet pranë Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

**Profili i Kandidatëve :** Fusha Bujqësore, Ekonomike dhe Inxhinierike

**Kohëzmatja:** 15 Javë

**Plani mësimor përfshin lëndët e mëposhtme:**

Nr.	Moduli	Pedagogu	Google Site
1	Toka dhe Pjelloria e Saj	Prof. Dr. Ilir Kristo Prof. Dr. Ardian Maçi	<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/ilir-kristo/home">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/ilir-kristo/home</a> <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/ardian-maci/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/ardian-maci/</a>
2	Ligjshmëria dhe Aspektet Mjedisore të Tokës në Shqipëri	Prof. Dr. Seit Shallari Dr. Jolia Korita	<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/seit-shallari/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/seit-shallari/</a> <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/jolia/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/jolia/</a>
3	Bazat e Vlerësimit dhe Menaxhimi i Tokës Bujqësore	Prof. Dr. Fatbardh Sallaku	<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/fatbardh-sallaku/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/fatbardh-sallaku/</a>
4	Vlerësimi i Tokave Pyjore, Kullotave, Livadheve dhe Tokave jo Produktive	Prof. Dr. Fran Gjoka Prof. Elvin Toromani	<a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/fran-gjoka/">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/fran-gjoka/</a> <a href="https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/elvin-toromani">https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/elvin-toromani</a>

**Shënim:** Kontrolli i dijeve të fituara do të bëhet me provim me shkrim në fund të programit të lëndëve.

**Kontakt:**

**e-mail:** [dame.ubt@gmail.com](mailto:dame.ubt@gmail.com) / [ssulaj@hotmail.com](mailto:ssulaj@hotmail.com)



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**  
**FAKULTETI I BUJQESISË DHE MJEDISIT**  
**DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISË**

Tiranë, më \_\_\_\_ .01. 2019

**Lënda:** Dokumentat e nevojshme për regjistrim në kursin “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë dhe tokë e pafutëshme”

Organizimi i kursit të pasurive të paluajtshme për tokë bujqësore, tokë pyjore, kullotë, livadhe dhe tokë e pafutëshme do të zhvillohet pranë Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit. Për regjistrimin e të interesuarve duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në kurs;
2. CV e përmbledhur (maksimumi 2 faqe);
3. Kopje e diplomës Master (Master i Shkencave, Master Profesional, Diplomë e sistemit të vjetër 4-5 vjet) dhe listat e notave (të noterizuara);
4. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
5. Dy fotografi 4 x 4 cm;
6. Tarifa e regjistrimit 2500 Lek.